



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:202512
Datë: 24.01.2023
Numri i dokumentit: 03894092

PKR.nr.221/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. H. nga fsh.C. K. I., për shkak të veprës penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.65/2022 të datës 11.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.01.2023 në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit E. H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.24.01.2023, nxori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. H. i biri Q. dhe e nënës M., e gjinisë H., i lindur me dt.... në I., tani me banim në fsh.C., K. I., ka të kryer shkollën e mesme, i identifikuar me numër personal, me profesion zdruktare, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon telefon me numër .../...-..., Shqiptare, Shtetas e Republikës së Kosovës, **tani gjendet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt. 06.10.2019, në Shkollën fillore “B.C.”, në fsh. C., K.I., vendvotimi nr./...., në zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme të organizuara me atë datë, duke vepruar si kryesues dhe përgjegjës i Këshillit të Vendvotimit (KVV) i caktuar nga rradhët e subjektit politik L.V., shton dhe heq votat duke falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që, në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR) dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), falsifikon gjithsej njëqindeshtatëdhjetedy (172) vota, ku prej tyre njëqindëgjashatëdhjetetë (163) vota janë të shtuara dhe nëntë (9) vota të hequra dhe atë të shtuara janë A.-P. 114 vota, L. 1 votë, L. 48 vota, dhe të hequra janë A.-P.3 vota, L. 2 vota dhe L. 4 vota, shifra këto që kanë rezultuar pas procesit të rinumërimit të votave, proces ky i zhvilluar me dt. 09.03.2022, për vendvotimin në fjalë,

- me çka ka kryer veprën penale “**Falsifikimi i rezultateve të votimit**”, nga neni 216, par. 2, lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë të nenit 4, 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50,60, 63, 69, 70, 71,72, nga neni 216, par. 2, lidhur me par. 1 të KPRK-së, nenit 365, 366, 453, të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

- I. Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Dënimi me kusht nga dispozitivi i këtij aktgjykimi do të revokohet nëse i akuzuari kryen veprën tjetër penale.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej 20 (njëzet) euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjete) euro ne emër të kompensimit të viktimave të krimit.
- IV. E të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.
- V. Ndaj të pandehurit E. H. i shqiptohet:

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S – M A R R J A E S E N D I T / K O N F I S K I M I

NDALIMI – HEQJA E TË DREJTËS PËR TU ZGJEDHUR DHE NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, I VEPRIMTARISË OSE DETYRËS, ashtu që i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidat për zgjedhjet Lokale apo Qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhgues, kryesues, komisioner apo pozita tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/I. Nr.65/2022 të datës 11.11.2022, kundër të akuzuarit E. H. nga fsh.C., K. I., për shkak të veprës penale “*Falsifikimi i rezultateve të votimit*” nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 20.01.2023 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosa dhe i akuzuari E. H..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit nën shenjen PP/I. Nr.65/22 të datës 11.11.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të akuzuarit E. H., gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë i premtoi gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarit E. H. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetjen në shkesat të lëndës dhe i propozoj gjykatës që ketë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarës vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarës, pasi që ajo e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngasë pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Tabela me të dhëna specifike mbi diferencën e numrit të votave të kandidatëve; Libri i votimit, për vendvotimin/..., në P.; Formulari i Rezultateve të Kandidatëve, për vendvotimin nr./...; Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, për vendvotimin nr./..., pas rinumërimit; Formulari i Rezultateve të Kandidatëve, për vendvotimin nr./..., pas rinumërimit; Raporti i hetuesit E. K #..., i përpiluar nën nr. të rastit: ...-DI..., dt. 03.03.2022; Vendimi i KQZ-së për formimin e komisionit për rinumërimin e fletëvotimeve për vendvotimin/..., nën nr. .../..., dt. 15.04.2022; Formulari i Rezultateve të Kandidatëve, për vendvotimin nr. .../..., pas rinumërimit sipas kërkesës së Prokurorisë, me dt. 21.04.2022; Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, për vendvotimin nr. .../..., pas rinumërimit sipas kërkesës së Prokurorisë, me dt.18.10.2022 dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri E. H. gjate shqyrtimit fillestar e pranoi fajësinë, unë në tërësi mbes pranë aktakuzës, përshkrimin faktik dhe juridik të veprës penale dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligon në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale. Me rastin e marrjes së vendimit bë lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen e tij korrekte, gjendjen e tij të dobët ekonomike, mosdenushmerin e tij të mëparshme, ndërsa si rrethane rënduese në rastin konkret nuk kemi gjetur asgjë. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që ndaj të njëjtit të shqipton dënim plotësues si në aktakuze.*

I akuzuari E. H. në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat lehtësuese*

të potencuar nga Prokurorja e shtetit, me vjen keq që ka ndodhur, nuk do të përsëritet më, kjo është hera e pare që ka ra ndesh me ligjin, lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë. .

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Falsifikimi i rezultateve të votimit” nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i akuzuari ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që e akuzuara ka qenë e vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të akuzuarin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese mori se nuk ka qenë asnjëherë i akuzuar për ndonjë vepër penale, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, koha e kaluar që nga kryerja e veprës penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar. Ndërsa rrethana rënduese kjo Gjykatë nuk gjeti për të akuzuarin. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 nën par.1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 72 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, kur ka shqiptuar dënimin me burgim nën kufirin e paraparë me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për të akuzuarin dhe ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Dënimi plotësues konform nenin 59, 60 dhe 63 të KPRK, përveç dënimit alternativ (dënimin me kusht), ndaj të akuzuarit E. H., iu është shqiptuar edhe dënimi plotësues heqja e të drejtës për tu zgjedhur dhe ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje prej 1 viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Pra të njëjtit i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidat për zgjedhjet lokale apo qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhgues, kryesues, komisionar apo pozita të tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale u mor në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.221/22 dt. 24.01.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale,
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc.Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.